



## TERMAT E REFERENCËS

<b>Lloji i shërbimit</b>	Trajnime në fushën e ngritjes së kapaciteteve të të rinjve në procese vendimmarrëse dhe avokim  <b>Tematikat:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ndërtimi i ekipit dhe shkathhtësitë e komunikimit - <i>trajnim 1-ditor</i></li><li>- Zhvillimi personal, lidhshipi, aktivizimi në shoqëri - <i>trajnim 1-ditor</i></li><li>- Pjesëmarrja në procese vendimmarrëse dhe avokimi i të rinjve - <i>trajnim 1-ditor</i></li></ul>
<b>Vendndodhja</b>	Prishtinë, Kosovë
<b>Lloji i konsulencës</b>	Kompani
<b>Kohëzgjatja</b>	Gusht 2023 – Shtator 2023
<b>I raportohet</b>	SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë

### 1. Hyrje

Këto Terma të Referencës shërbejnë si një kërkesë për propozime nga kompani që janë të interesuar në hartimin dhe mbajtjen e trajnimeve për të rinjtë që janë të përkrahur nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë në fushën e ngritjes së kapaciteteve të të rinjve në procese vendimmarrëse dhe avokim.

### SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve International është organizata ombrellë për federatën globale të 118 shoqatave kombëtare SOS Fshatrat e Fëmijëve, duke punuar në më shumë se 2500 vende programesh në të gjithë botën. Ne punojmë së bashku me një vizion të vetëm: çdo fëmijë i përket një familjeje dhe rritet me dashuri, respekt dhe siguri. Në mënyrë unike, ne ofrojmë kujdes afatgjatë familjar për fëmijët që kanë humbur kujdesin prindëror dhe ne punojmë me familje dhe komunitete në nevojë për t'i ndihmuar në fuqizimin e tyre dhe parandalimin e braktisjes së fëmijëve. Që nga viti 2001, SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë ka qenë aktiv në fushën e mbrojtjes sociale përmes sigurimit të shërbimeve të kujdesit të drejtpërdrejtë me cilësi të lartë për fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror përmes zhvillimit të mjediseve alternative të kujdesit familjar dhe shërbimeve me bazë në komunitet për familjet në rrezik. Brenda SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe programeve të fuqizimit të familjes, ne punojmë së bashku drejt vizionit tonë për një botë ku “çdo fëmijë i përket një familjeje dhe rritet me dashuri, respekt dhe siguri”. SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë punojnë në partneritet me bartësit e detyrës, organet shtetërore, palët kryesore të interesit, organizatat kryesore dhe ofruesit e shërbimeve në fushën e mbrojtjes sociale dhe



fëmijët në nevojë dhe krijojnë mundësi që të rinjtë të përfshihen në ndikimin, formësimin, modelimin dhe kontributin në politikat dhe zhvillimin e shërbimeve dhe programeve.

### **1.1 Përmbledhje e programit**

SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, duke marrë parasysh punën profesionale që ofrohet brenda organizatës, dhe në kuadër të misionit të saj, parasheh edhe ngritjen në vazhdimësi të kapaciteteve të të rinjve në zhvillimin e tyre personal dhe fuqizimin e tyre në avokim dhe në proceset vendimmarrëse.

Duke marrë parasysh të gjitha informatat e lartpërmendura, SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, po kërkojnë kompani të specializuara në fushën e punës me të rinjë për të ofruar trajnime me tematikat: Ndërtimi i ekipit dhe shkathtësitë e komunikimit; Zhvillimi personal, lidershipi, ndërtimi i karrierës; Pjesëmarrja në procese vendimmarrëse dhe avokimi i të rinjve.

### **1.2 Kohëzgjatja e trajnimeve**

Data e parashikuar e realizimit të trajnimit 3 ditor është muaji gusht deri në 30 shtator 2023.

## **2. Qëllimi i angazhimit:**

Qëllim i këtyre trajnimeve është të rris njohuritë dhe kapacitetet e të rinjve që mbështeten nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë për të zgjeruar njohuritë dhe kapacitetet e tyre në zhvillimin personal, të udhëheqjes, komunikimit, pjesëmarrjes, avokimit, etj.

### **2.1 Temat e trajnimit:**

**Trajnimi 1:** Ndërtimi i ekipit dhe shkathtësitë e komunikimit (*trajnim 1-ditor*)

**Trajnimi 2:** Zhvillimi personal, lidershipi, aktivizimi në shoqëri (*trajnim 1-ditor*)

**Trajnimi 3:** Pjesëmarrja në procese vendimmarrëse dhe avokimi i të rinjve (*trajnim 1-ditor*)

### **2.2. Rezultatet e pritshme:**

Pjesëmarrësit do të pajisen me njohuri të nevojshme në zotërimin e teknikave dhe metodave që ndikojnë në komunikimin, ndërveprimin dhe aktivizimin e tyre në shoqëri.

Gjatë procesit të hartimit të moduleve të trajnimit dhe zhvillimi të punëtorive, Trajneri duhet të respektojë kulturën e pjesëmarrësve, normat shoqërore, vlerat dhe sjelljet, si dhe të mbajë marrëdhënie të përshtatshme me pjesëmarrësit e përfshirë në këtë proces.

Trajneri duhet të respektojë konfidencialitetin e informacionit të ofruar gjatë trajnimeve. Pra duhet të nënshkruajë Kodin e Mirësjelljes, Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të gjitha deklaratat përkatëse që garantojnë mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin përpara fillimit të vlerësimit.



Trajnimi duhet të përfshijë, por jo domosdoshmërisht të kufizohet në informacionin vijues të renditur më poshtë:

- Metodologjia e Trajnimit (përfshirë materialet e propozuara të trajnimit, aktivitete dhe shembuj praktikë)
- Agjenda;
- Prezantimi i materialit
- Aktivitete praktike;
- Diskutime ndërvepruese;
- Vlerësimi i trajnimit dhe trajnerit.

Trajneri do të jetë përgjegjës për të realizuar në gjuhën shqipe detyrat e mëposhtme:

- Zhvillimin e një metodologjie trajnimi, materialeve të trajnimit, prezantimet për pjesëmarrësit e trajnimit dhe agjendën në përputhje me këtë TeR dhe në konsultim me ekipin e SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë.
- Mbajtja e trajnimeve
- Krijon një raport përmbledhës për mbarëvajtjen e trajnimit

**Rreth 25 pjesëmarrës do të marrin pjesë në çdo trajnim.**

### **Produktet:**

1. Drafti përfundimtar i moduleve të trajnimit (përfshirë materialet e trajnimit, shembuj praktikë, aktivitetet praktike, diskutimet ndërvepruese, dhe agjendën) shkruar në shqip;
2. Mbajtja e trajnimeve
3. Raporti përfundimtar - raporti përmbledhës i mbarëvajtjes së trajnimit bazuar në vlerësimin e trajnimit.

### **3. Shkathtësitë e kërkuara (Përvoja dhe Kualifikimet):**

- Kompetenca/përvoja e dëshmuar (dëshmia e përvojave të mëparshme) në përpilimin e moduleve të trajnimit dhe kryerjen e trajnimeve.
- Trajnerët e propozuar nga kompania duhet të kenë diplomë universitare në fushë përkatëse ose përvojë ekuivalente profesionale.
- Duhet të ketë aftësi të forta analitike dhe konceptuale.
- Përvojë të dëshmuar në ofrimin e kurseve të specializuara të trajnimit.
- Përvojë të mëhershme në punën në rolin e ndërtimit të kapaciteteve.
- Trajnerët e propozuar duhet të kenë aftësi të shkëlqyera të shkrimit dhe komunikimit.
- Duhet të ketë aftësi të mira personale dhe ndër personale të punës në ekip.
- Duhet të garantojë arritjen në kohë të rezultateve dhe detyrave të pritura.
- Duhet të jetë i njohur me standardet etike për çështje që lidhen me fëmijët dhe kërkohet që të nënshkruajnë dhe t'i përmbahen Politikave të SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë.



- Autori nuk duhet të përdorë materiale të mbrojtura nga e drejta e autorit.

#### 4. Kriteret për përzgjedhje janë:

Kriteret	Pikët maksimale
<ul style="list-style-type: none"><li>• Portofolio e kompanisë me dëshmi të përvojës së punës /ekspertizë të dëshmuar në zhvillimin e trajnimeve të tilla</li><li>• CV-të e trajnerit/ve të propozuar që përfshihet në trajnim</li><li>• Dy referenca të kompanisë</li></ul>	30
<ul style="list-style-type: none"><li>• Propozimi i konceptit të metodologjisë së trajnimit duke përfshirë referencat për materialet dhe agjendën e trajnimit</li></ul>	30
<ul style="list-style-type: none"><li>• Çmimi i propozimit financiar</li></ul>	40
<b>Totali</b>	<b>100</b>

Të gjithë ofertuesit duhet të plotësojnë kriteret thelbësore. Do të ketë maksimum 100 pikë të ndara sipas kriterëve.

#### 5. Kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet e pagesës

Pagesa do të bëhet nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, me pranimin e punës së kryer në përputhje me modulet e përshkruara më lart. Pagesa do të kryhet me transfer bankar brenda afatit prej 15 ditësh pas ofrimit të shërbimit të secilit modul.

#### 6. Të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera pronësore

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë do të ketë të drejtën e të gjithë pronësisë intelektuale dhe të drejtave të tjera pronësore, por pa kufizime ndaj të drejtës së kopjimit, në lidhje me raportin, proceset, idetë, dokumentet dhe materialet e tjera që Kontraktori ka zhvilluar për SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, sipas kontratës, dhe të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me përgatitjen e gjetjeve.

Të gjitha materialet: planet, raportet, vlerësimet, rekomandimet, dokumentet dhe të gjitha të dhënat e tjera të hartuara nga Kontraktori ose të pranuar nga Kontraktori do të jenë pronë e SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë dhe do të trajtohen si konfidenciale dhe do të dorëzohen vetëm në SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë në fund të punës sipas kontratës.

E drejta e kopjimit e produkteve do t'i përkasë SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë dhe individit/kompania nuk do të jetë i autorizuar t'i përdorë ose riprodhojë ato diku tjetër.



## 7. Shtojca – Politikat e SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë e ka dokumentin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve dhe kodin e sjelljes, të cilat eksperti pritet t'i përmbahet dhe nga ta do të kërkohet ta nënshkruajnë deklaratën e përkushtimit ndaj Politikave të SOS Fshatrave të Fëmijëve të cilat përfshijnë: Politikës për mbrojtjen e fëmijëve, Rregullorja për Parandalimin dhe mbrojtjen kundër ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, Kodin e mirësjelljes si dhe Deklarata për ruajtjen e të dhënave. Kjo do të bëhet me rastin e nënshkrimit të kontratës, ku konsulenti do të udhëzohet lidhur me proceset e brendshme të mbrojtjes së fëmijëve dhe rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave.

Para fillimit aktual të mbledhjes së të dhënave, duhet të sigurohet një verifikim, në rast se planifikohen të dhëna të ndjeshme.

Përveç sa u tha më sipër, fushat e mëposhtme kryesore për shqyrtim etik duhet të merren parasysh: <http://childethics.com/ethical%20guidance/>

Graham, A., Poëll, M., Taylor, N., Anderson, D. & Fitzgerald, R. (2013). Kërkime etike që përfshijnë fëmijët. Firencë: UNICEF Zyra e Kërkimit - Innocenti.

## 8. Udhëzim për ofertuesit (Procesi i dorëzimit të Ofertave)

Ofertuesit janë të mirëpritur të dërgojnë propozimin e tyre për *“Trajnime në fushën e pjesëmarrjes dhe fuqizimit të të rinjve”*- në mënyrë elektronike në formatin PDF dhe në adresën elektronike [procurement1@soskosova.org](mailto:procurement1@soskosova.org)

Ftesa është e hapur për të gjithë kompanitë që mund t'i ofrojnë shërbimet e kërkuara. Propozimi dhe të gjitha dokumentet plotësuese duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe.

### Dokumentet për tu dorëzuar:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit/ NUI;
- Oferta duhet të jetë me logo e nënshkruar dhe vulosur
- Oferta financiare duhet të deklarohet në EURO pa TVSH
- Dorëzimi i ofertave: Koncept propozimi për metodologjinë e trajnimit duke përfshirë referencat për modulet/materialet dhe agjendën e trajnimit
- Portofolio e kompanisë
- Emri dhe detajet kontaktuese të trajnerit, si dhe përshkrimi i përvojave relevante në të kaluarën (Lista e trajnimeve të mëparshme të ofruara),
- CV e trajnerit/ve
- Dy Letër referenca

Oferta duhet të jetë e vlefshme për dy javë:

**Ofertuesi i përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë Vërtetimin Tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës**

Afati i fundit për aplikim është data: 27.07.2023 deri në mesnatë. Aplikacioni i dërguar pas afatit nuk do të merret në konsideratë.